



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT

Prishtinë, 30 Dhjetor 2025

Nr. 4

BULETINI INFORMATIV

Korrik - Dhjetor 2025



SUKSES I RRADHËS PËR FAKULTETIN E EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT!

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit në Universitetin e Prishtinës vazhdon të dëshmojë cilësinë dhe përkushtimin e tij shkencor, katër projekte të këtij fakulteti janë përzgjedhur si përfitues të financimit nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) për vitin 2025, në kuadër të thirrjes për projektet e vogla shkencore!

Në ceremoninë zyrtare të nënshkrimit të kontratave, të zhvilluar në prani të Ministres në detyrë znj. Arbërie Nagavci dhe Zëvendësministrit z. Arsim Ademi, Fakulteti ynë u përfaqësua me krenari si një ndër njësitë akademike më të suksesshme për nga numri i projekteve të miratuara.

Ky është një tregues i qartë i angazhimit serioz të stafit tonë akademik në kërkime shkencore, si dhe i vlerësimit të lartë institucional që i bëhet fushës së sportit dhe edukimit fizik në zhvillimin shoqëror, shëndetësor dhe edukativ të vendit.

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit mbetet i përkushtuar ndaj misionit të tij për zhvillimin e qëndrueshëm të edukimit fizik dhe sportit në vend. Faleminderit MASHTI për besimin dhe mbështetjen!



PROVIMI PRANUES 2025 | SUKSES, DISIPLINË DHE TRANSPARENÇË

Me përkushtim maksimal dhe organizim shembullor, ka përfunduar me sukses provimi pranues në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit!

Falënderojmë sinqerisht të gjithë aplikantët e shumtë që ishin prezent dhe treguan interes të jashtëzakonshëm për t'u bërë pjesë e familjes sonë akademike. Ju vlerësojmë për angazhimin, disiplinën dhe përgatitjen që treguat gjatë gjithë procesit!

Më poshtë mund të shihni disa nga momentet frymëzuese dhe dinjitoze nga dita e provimit





STUDENTËT E FEFS ORGANIZOJNË AKTIVITETE PËR STUDENTËT NDËRKOMBËTARË NË KUADËR TË UNIVERSITETIT VEROR!

Me krenari dhe përkushtim, studentët tanë të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit po udhëheqin aktivitetet fizike dhe rekreative për pjesëmarrësit ndërkombëtarë të Universitetit Veror të Universitetit të Prishtinës.

Në një atmosferë dinamike dhe mikpritëse, ata po prezantojnë vlerat e sportit, bashkëpunimit dhe energjisë rinore që i karakterizon.

Jemi krenarë për studentët tanë që me profesionalizëm dhe pasion po kontribuojnë në këtë ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare, duke e përfaqësuar fakultetin dhe vendin me dinjitet.



STUDENTJA E FAKULTETIT TË EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT, FUTBOLLISTE E KOMBËTARES SË KOSOVËS, LUMBARDHA MISINI, KA NËNËSHKRUAR ME KLUBIN E NJOHUR ZVICERAN SERVETTE FC CHËNOIS FËMININ!

Ky është një hap i rëndësishëm në karrierën e saj, me ç'rast Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit i uron Lumbardhës shumë suksese në vazhdimin e karrierës ndërkombëtare. Profesorët, studentët dhe i gjithë stafi i fakultetit i dëshirojnë fat, shëndet dhe suksese, duke i qëndruar gjithnjë në përkrahje.

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit – shtëpia e sportistëve!



PRISHTINA TRAINING & WELLNESS EVENT

Në bashkëpunim me organizatorët e eventit nga First Fit Studio, u mbajt eventit Prishtina Training & Wellness, i cili synon promovimin e një jete të shëndetshme përmes aktivitetit fizik dhe vetëkujdesit.

Në këtë ngjarje morën pjesë edhe përfaqësues nga Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit, përkatësisht profesori Arsim Qirriqi si dhe tre studentë: Uran Bala, Neshat Krasniqi dhe Hanife Berisha, të cilët kontribuan në rolet e Coach, Judge dhe Referee, duke sjellë përvojën dhe profesionalizmin e tyre në shërbim të pjesëmarrësve dhe zhvillimit të eventit.

Gjithashtu, në garat e organizuara gjatë eventit, morën pjesë edhe disa studentë të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit si garues, duke e bërë pjesëmarrjen e këtij institucioni edhe më të plotë dhe domethënëse.

Ky bashkëpunim është dëshmi e rëndësisë së lidhjes mes institucioneve akademike dhe organizatave të fushës së fitnesit për të ndërtuar një komunitet më të shëndetshëm dhe të ndërgjegjshëm për mirëqenien fizike dhe mendore.



FORTESA BERISHA, STUDENTE NË FAKULTETIN E EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT, KA NËNSHKRUAR KONTRATË ME KLUBIN ITALIAN FC COMO, QË GARON NË ELITËN E FUTBOLLIT – SERIE A!

Ky është një tjetër sukses i jashtëzakonshëm për studentet tona. Fortesa po ndjek ëndrrat e saj në njërin nga ligat më të forta të Evropës, duke dëshmuar përkushtimin, talentin dhe profesionalizmin që e karakterizojnë.

Në emër të profesorëve, studentëve dhe stafit të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, i urojmë Fortesës një rrugëtim të suksesshëm, shëndet dhe arritje të reja në arenën ndërkombëtare. Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit – aty ku hapet dritarja e dijes dhe suksesit.



FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT PARTNER DHE PËRFITUES I PROJEKTIT NDËRKOMBËTAR „WE RUN”

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit i Universitetit të Prishtinës do të jetë partner, përfitues dhe zbatues i transferimit në Kosovë të projektit ndërkombëtar „We Run”.

Projekti „We Run” ka në qendër fuqizimin e grave nëpërmjet sportit bazë, duke promovuar shëndetin dhe aftësitë e tyre me anë të krijimit të komuniteteve të sigurta që do të drejtohen nga vetë gratë. Ai financohet nga programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian.

Ky model i suksesshëm në Austri, i zhvilluar nga organizata „261 Club Austria”, po zbatohet tani në Shqipëri dhe po përgatitet për transferim në Kosovë, me përfshirjen aktive të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit.

Projekti „We Run” do të bëjë:

Trajnimin e trajnereve të vrapimit në Shqipëri dhe Kosovë;

Krijimin e katër grupeve të vrapimit në dy rajone shqiptare;

Trajnimin e tri grave lidere për ta transferuar modelin në Kosovë;

Zhvillimin e planeve të qëndrueshme dhe strukturave afatgjata.

Kjo nismë shënon një hap të rëndësishëm për shtimin e numrit të grave e vajzave në sporte të ndryshme dhe ndërtimin e komuniteteve më të forta dhe të barabarta në rajon.

Universiteti i Prishtinës dhe fakultetet përbërëse të tij në vazhdimësi fitojnë grante ndërkombëtare për projekte të ndryshme, nga të cilat përfitojnë studentët dhe personeli mësimor i UP-së, por edhe qytetarët dhe shteti i Kosovës.



MIRËNJOHJE PËR Z. GANI IBRAHIMIN ME RASTIN E PENSIONIMIT

Me rastin e përfundimit të detyrës dhe daljes në pension të Sekretarit të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, Z. Gani Ibrahim, dëshirojmë të shprehim mirënjohjen e thellë për kontributin e tij të gjatë dhe të çmuar në funksionimin dhe zhvillimin e njësisë sonë akademike.

Gjatë dekadave të punës së tij, Z. Ibrahim ka treguar përkushtim, profesionalizëm dhe integritet të lartë në ushtrimin e detyrave, duke qenë një figurë e qëndrueshme dhe e besueshme në mbështetje të stafit akademik, administrativ dhe studentëve. Me qetësinë dhe korrektësinë që e karakterizojnë, ai ka ndihmuar në krijimin e një mjedisi funksional dhe bashkëpunues brenda institucionit.

Kontributi i tij përbën një pjesë të rëndësishme të historikut të Fakultetit, dhe do të vlerësohet gjithmonë si pjesë e trashëgimisë institucionale që ai lë pas. Edhe pse formalisht mbyllet një kapitull i rëndësishëm, prania dhe mbështetja e tij mbeten të mirëseardhura dhe të çmuara. Prof. Ibrahim vazhdon të mbetet një bashkëpunëtor i nderuar dhe një zë i respektuar brenda komunitetit tonë akademik.

Gjurmët që ai la pas nuk fshihen lehtë por mbeten aty në kujtesën, kulturën dhe shpirtin e institucionit tonë.



Me këtë rast, i urojmë Z. Ibrahim shëndet dhe qetësi në këtë fazë të re të jetës, duke e falënderuar për shërbimin e tij të çmuar për FEFS-në.



NË HAPËSIRAT TONA JANË ZHVILLUAR TESTIMET FIZIKE DHE MJEKËSORE PËR EKIPIN MË TË SUKSESSHËM SHQIPTAR NË BASKETBOLL – KB SIGAL PRISHTINA

Ky proces, i realizuar me aparaturat më moderne dhe standardet më të larta shkencore, është dëshmi e përkushtimit të Fakultetit tonë për të qenë gjithmonë në shërbim të sportit elitare dhe zhvillimit të sportistëve më të mirë të vendit.

Ne jemi krenarë për stafin tonë profesional që bën të mundur ofrimin e këtyre shërbimeve të nivelit më të lartë për klubet sportive, duke kontribuar drejtpërdrejt në ngritjen e performancës dhe suksesit të tyre. Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit – aty ku shkenca takohet me sportin, dhe ku lind sukcesi i kampionëve!



TAKIMI I RADHËS MES FAKULTETIT TË EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT DHE SHOQATËS ALUMNI

Në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit është mbajtur takimi i radhës me Shoqatën Alumni të fakultetit tonë.

Në këtë takim u diskutua për fuqizimin e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe për projektet e reja ku Fakulteti dhe Shoqata Alumni do të jenë partnerë aktivë.

Përgëzojmë anëtarët e bordit të shoqatës për angazhimin dhe punën e tyre të vazhdueshme në ngritjen dhe forcimin e rolit të Fakultetit tonë në komunitet dhe përfaqësimin e dinjitetshëm të tij në arenën shoqërore e sportive.



MBAHET MBLEDHJA E KOMISIONIT PËR STUDIME

Komisioni për Studime në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit u mbledh sot, në prag të nisjes së vitit të ri akademik 2025-2026. Gjatë këtij takimi u diskutua me përkushtim për organizimin sa më efektiv dhe cilësor të vitit akademik të ardhshëm, me qëllim përmirësimin e procesit mësimor dhe zhvillimin e mëtejshëm të fakultetit.


Një pjesë e rëndësishme e diskutimeve ishte shqyrtimi i programeve mësimore aktuale, duke analizuar mundësitë për përditësim dhe adaptim sipas kërkesave moderne dhe nevojave të studentëve. Gjithashtu, u morën në konsideratë kërkesa të ndryshme nga stafi akademik dhe administrata, të cilat synojnë përmirësimin e kushteve të punës dhe të studimit.

Komisioni konfirmoi angazhimin e tij për të punuar në mënyrë të koordinuar dhe efikase, në mënyrë që Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit të vazhdojë të ofrojë një edukim të lartë dhe cilësor.



INSTITUTI I SHKENCAVE TË SPORTIT-FEFS,NË MBËSHTETJE TË SPORTISËVE

Medaliste e bronzë në Kampionatin Evropian U21 & U23 dhe 🏆 Kampione Ballkanike për seniorë në xhudo – Flaka Loxha vazhdon të shkëlqejë si një prej sportistëve më të suksesshëm të Kosovës. Së fundi, Flaka u testua në Institutin e Shkencave të Sportit në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit me qëllim të vlerësimit të nivelit të performancës dhe procesit të rikuperimit pas lëndimit në krah. FEFS është gjithmonë e gatshme të mbështesë sportistët kulmorë në rrugëtimin e tyre drejt rezultateve më të larta ndërkombëtare. Forca, vullneti dhe profesionalizmi i Flakës në xhudo janë frymëzim për të rinjtë dhe për sportin e Kosovës.



ATMOSFERË EMOCIONUESE NË PRITJEN E STUDENTËVE TË RINJ NË FAKULTETIN E EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT

Ceremonia e pritjes së studentëve të rinj në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit u zhvillua me një atmosferë të veçantë festive, ku emocionet dhe energjia pozitive e bënë ditën të paharrueshme.

Në kuadër të programit, studentët tanë aktualë shkëlqyen me paraqitjet e tyre, duke dhënë shembullin më të mirë të angazhimit, përkushtimit dhe talentit që mbartin. Ata treguan vlerat e vërteta të FEFS-it dhe ishin dëshmia më e qartë e cilësisë së këtij fakulteti.

Gjatë ceremonisë u shpërndanë edhe mirënjohje për kontribuesit tanë të dalluar, ndërsa një vend të veçantë zuri nderimi për ish-dekanët e fakultetit, të cilët u vlerësuan për rolin e tyre të pazëvendësueshëm në zhvillimin e institucionit.

Krenarë për studentët tanë - të rinj e aktualë - që me punën dhe entuziazmin e tyre e bëjnë fakultetin tonë të jetë një vatër e vërtetë e dijes dhe sportit.

Na priftë e mbara në këtë vit të ri akademik!





RESPEKT DHE MIRËNJOHJE PËR ISH-DEKANËT E FEFS-IT

Dekani i Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit priti sot dy ndër figurat më të rëndësishme të historisë së fakultetit, ish-dekanët prof. dr. Behlul Brestovci dhe prof. dr. Sadik Krasniqi. Në një atmosferë miqësore dhe respekti, u shpreh mirënjohja për kontributin e tyre shumëvjeçar në zhvillimin e fakultetit. Trashëgimia e punës së tyre mbetet një vlerë e çmuar dhe frymëzim për të gjithë komunitetin akademik e studentor të FEFS-it.



NË KUADËR TË PROJEKTIT SHAPE PO VIJON “WEST BALKAN WEEK OF SPORT”, FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT GJATË KËSAJ JAVE KA ZHVILLUAR AKTIVITETE DHE TAKIME TË NDRYSHME ME SHFMU "FAIK KONICA" NË PRISHTINË



WEST BALKAN WEEK OF SPORT KA VAZHDUAR AKTIVITETET SOT ME “SPORT FORUM 2025”

Në ambientet e Hotelit Sirius në Prishtinë u mbajt Sport Forum 2025, aktivitet ky i organizuar në kuadër të EWOS. Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit mori pjesë si partner i projektit SHAPE, në kuadër të së cilit po zhvillohet edhe West Balkan Week of Sport e cila realizohet në bashkëpunim me partnerët e SHAPE, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Komitetin Olimpik të Kosovës (KOK), si dhe institucione të tjera vendore e ndërkombëtare.

Sport Forum 2025 mbledhi përfaqësues nga:

Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit,
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
Komiteti Olimpik i Kosovës,
Partnerët e projektit SHAPE,
Profesorë, gazetarë dhe studentë.

Forumi përfshiu dy panele diskutimi me tema aktuale dhe me rëndësi për zhvillimin e sportit:

Diskutim Paneli 1: Inteligjenca Artificiale në Sport

Tema: Inteligjenca Artificiale në Sport: Mundësi për Performancë dhe Sfida Etike

Pikat kryesore të diskutimit:

Përdorimi i AI-së për përmirësimin e performancës: analiza e të dhënave të lojtarëve, monitorimi i lodhjes dhe parashikimi i lëndimeve.

AI dhe shëndeti i sportistëve: personalizimi i trajnimit dhe ushqimit sipas gjendjes fizike.

E ardhmja e sportit: a do ta zëvendësojë AI trajnerin apo do të mbetet një mjet mbështetës?

Etika dhe barazia: rreziku i krijimit të pabarazive kur teknologjia e avancuar përdoret vetëm nga ekipet e pasura.

Diskutim Paneli 2: Aktivitetet fizike dhe sporti si faktorë kyç në promovimin e shëndetit të njeriut

Tema: Sporti dhe Rekreacioni si Motor i Tranzicionit të Gjelbër: Rugë të Qëndrueshme për një Stil Jete të Shëndetshëm

Pikat kryesore të diskutimit:

Roli i sportit dhe rekreacionit në promovimin e ndërgjegjësimit për çështjet mjedisore.

Aktivitetet në natyrë dhe rekreacioni i bazuar në mjedis si nxitje për vlerësimin e ekosistemeve.

Integrimi i praktikave miqësore me mjedisin në infrastrukturën dhe ngjarjet sportive.



FEFS-SHAPE/FUNDJAVË E MBUSHUR ME AKTIVITETE SPORTIVE

Gjatë kësaj fundjave, Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit ka vazhduar me aktivitetet në kuadër të "West Balkan Week of Sport", duke realizuar një sërë ngjarjesh sportive në kuadër të projektit SHAPE, përfshirë edhe pjesëmarrjen në "Park Run and Walk" në Parkun e Gërmisë, me synimin për të përçuar mesazhin se sporti është për të gjithë, pavarësisht moshës, gjinisë, racës apo nivelit të përgatitjes fizike.

"Park Run and Walk" përfshiu vrapim dhe ecje në natyrë, duke krijuar një atmosferë pozitive, të hapur dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë pjesëmarrësit – studentë, qytetarë dhe dashamirë të sportit.

Qëllimi kryesor i këtyre aktiviteteve ishte promovimi i një jetese të shëndetshme dhe aktive, si dhe nxitja e përfshirjes së komunitetit – veçanërisht të të rinjve dhe studentëve në mënyrë që sporti dhe aktiviteti fizik të bëhen pjesë e përditshmërisë së tyre.



VAZHDOJMË TRADITËN E NDERIMIT TË ISH-DEKANËVE TË FAKULTETIT TË EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT

për kontributin e tyre të çmuar. Së fundmi, me mirënjohje është vlerësuar Prof. Asoc. Ajvaz Berisha, si shenjë respekti për punën dhe përkushtimin e tij gjatë mandatit.



NË KUADËR TË RENOÏMIT TË FEFS, ZHVILLIAM TAKIM ME PËRFAQËSUESIT E KOMPANIVE ASSEMBLAGE (FRANCË) DHE ABKONS, LIDHUR ME ORGANIZIMIN E LOJËRAVE MESHDETARE 2030 DHE MENAXHIMIN E STRUKTURAVE TË REJA QË DO TË NDËRTOHEN.



NDAHET ÇMIMI "HASAN PRISHTINA" PËR STUDENTËT E DALLUAR TË UP-SË

Në kuadër të aktiviteteve të organizuara nga Parlamenti Studentor, me rastin e Ditës së Studentëve, për herë të parë u nda çmimi "Hasan Prishtina" për studentët e dalluar të nivelit bachelor dhe master.

Me këtë çmim u nderuan edhe studentët tanë:

Aneta Beqiri (Master)

Aridon Luta (Bachelor)

Ky vlerësim është dëshmi e përkushtimit dhe arritjeve të tyre akademike, të cilat pasqyrojnë shembullin më të mirë të suksesit studentor.



FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT MIRËPRET PROF. DR. MEGAN CHAWANSKY NË KUADËR TË PROGRAMIT FULBRIGHT SPECIALIST!

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit në Universitetin e Prishtinës ka nderin dhe kënaqësinë të mirëpresë Prof. Dr. Megan Chawansky (she/her) nga Otterbein University – Department of Health & Sport Sciences (HSS), e cila po realizon programin e saj Fulbright Specialist pranë fakultetit tonë.

Tema e programit: “Coaching through Conflict: Building Resilient Athletes”

Ky program është pjesë e Fulbright Award RFP, përmes së cilës Prof. Chawansky po zhvillon hulumtim mbi ndikimet pasluftës në mirëqenien mendore të qytetarëve të Kosovës, me qëllim që të identifikohen pasojat afatshkurtra dhe afatgjata të konfliktit, të nxirren mësimet të vlefshme dhe të vlerësohet efektiviteti i ndërhyrjeve ekzistuese.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të ofrojë udhëzime konkrete për forcimin e mbështetjes për shëndetin mendor në kontekste post-konflikti, me theks të veçantë në rolin e sportit si mjet për ndërtimin e qëndrueshmërisë dhe mirëqenies psikologjike.

Ky program financohet nga Departamenti i Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe implementohet nga United States-Kosovo Educational Exchange Board (USKEB), në kuadër të përpjekjeve për të forcuar bashkëpunimin akademik dhe shkencor midis institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë dhe Shtetet e Bashkuara.

Fakulteti ynë është jashtëzakonisht i lumtur dhe i nderuar që Prof. Dr. Chawansky ka zgjedhur Universitetin e Prishtinës – Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit si institucionin ku do të realizojë këtë program prestigjioz.

Në takim morën pjesë menaxhmenti i Fakultetit, ku u shkëmbyen ide për bashkëpunime të ardhshme akademike, kërkimore dhe shkencore në fushën e sportit dhe shëndetit mendor.

Kjo vizitë përforcon lidhjet ndërkombëtare të Fakultetit dhe konfirmon rolin e tij në zhvillimin e projekteve me ndikim social dhe shkencor në nivel kombëtar e ndërkombëtar.



TRAJNIM PËR PËRDORIMIN E PAJISJEVE TË REJA TË SHIGURUARA NGA AMBASADA AMERIKANE NË KOSOVË!

Në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit – Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, po zhvillohet trajnimi në kuadër të projektit INSPIRE – Innovation in Sports Performance, Integration, Research, and Education, i cili synon forcimin e kapaciteteve kërkimore dhe profesionale të Institutit të Shkencave Sportive.

Ky trajnim realizohet falë donacionit të Ambasadës Amerikane në Kosovë, përmes programit University Support Grants, që administrohet nga Kosovo United States Alumni (KUSA).

Sesionet e trajnimit po udhëhiqen nga eksperti austriak Dr. Christoph Triska, i cili po ndan njohuri të avancuara mbi përdorimin praktik të pajisjeve moderne për matje dhe vlerësim të performancës fizike dhe kërkimeve në shkencat e sportit.

Pjesëmarrës në këtë trajnim janë stafi akademik dhe administratorët e Institutit të Shkencave Sportive, si dhe përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Fakulteti i Mjekësisë, duke përforcuar bashkëpunimin ndërinstitucional brenda Universitetit të Prishtinës.

Projekti INSPIRE ka për qëllim rritjen e kapaciteteve të Institutit të Shkencave Sportive të FEFS-së në ofrimin e shërbimeve të avancuara për komunitetin sportiv dhe më gjerë, si dhe forcimin e lidhjeve ndërmjet kërkimit shkencor, inovacionit, edukimit fizik dhe sportit.

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit shpreh mirënjohjen më të sinqertë ndaj Ambasadës Amerikane në Kosovë dhe organizatës KUSA për mbështetjen e vazhdueshme në fuqizimin e kapaciteteve akademike, kërkimore dhe infrastrukturore të fakultetit tonë.



DIVIZIONI PËR MONITORIM I AGJENCISË SË KOSOVËS PËR AKREDITIM KA VIZITUAR FAKULTETIN E EDUKIMIT FIZIK DHE TË SPORTIT

Në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe të Sportit është mbajtur një takim i rëndësishëm me ekipin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), nga Divizioni i Monitorimit.

Qëllimi i kësaj vizite ishte njoftimi dhe diskutimi rreth procesit të monitorimit që realizohet gjatë këtij viti akademik, në përputhje me Rregulloren nr. 04/2025 për Monitorim dhe Procedura Pasakredituese të AKA-së.

Gjatë takimit u zhvillua një diskutim i frytshëm dhe konstruktiv mbi mënyrën e zbatimit të standardeve dhe rregulloreve përkatëse të akreditimit, si dhe mbi rolin e bashkëpunimit ndërinstitucional për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë.

Menaxhmenti i Fakultetit të Edukimit Fizik dhe të Sportit ka shprehur gatishmërinë e plotë për bashkëpunim të ndërsjellë dhe për zbatimin e të gjitha kërkesave dhe udhëzimeve të dala nga rregulloret përkatëse.



STUDENTI I FEFS LUAR ALIU I PËRGATITUR PËR GARA

Studenti i nivelit Master, Luar Aliu, do të boksojë në boks profesionist më datë 18 Tetor 2025 në Korneuburg të Austrisë. Ai mori mbështetje nga Prof. Asoc. Dr. Musa Selimi, profesor i lëndës Kuptimi dhe Analiza e Performancës Sportive.

Kolegët dhe stafi i Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit i urojmë Luarit shumë sukses në këtë sfidë.



DEMONSTRIM I USHTRIMEVE NGA STUDENTËT NË LËNDËN E AKROBATIKËS

Studentët e nivelit Bachelor në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit nën udhëheqjen e Prof. Asst. Dr. Besim Halilaj në kuadër të lëndës Akrobatikë demonstruan ushtrime akrobatike që kërkojnë forcë fizike, ekuilibër, koordinim, bashkëpunim dhe besim të ndërsjellë.

Këto ushtrime janë pjesë e rëndësishme e përgatitjes profesionale të studentëve, duke kontribuar në zhvillimin e aftësive motorike, kontrollit të trupit dhe punës në grup - elemente thelbësore për të ardhmen e tyre si mësimsdhënës dhe trajnerë sportivë.



NDARJA E CERTIFIKATAVE PËR STUDENTËT QË KONTRIBUAN NË "WEST BALKAN WEEK OF SPORT"

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit u ka ndarë certifikata studentëve të cilët u angazhuan dhe kontribuan në mënyrë aktive në të gjitha aktivitetet e realizuara gjatë "West Balkan Week of Sport".


Kjo javë e veçantë e sportit, që bashkoi të rinjtë në aktivitete të ndryshme sportive dhe promovuese, u zhvillua në kuadër të projektit SHAPE, në të cilin Fakulteti ynë është partner. Gjatë javës, studentët tanë luajtën një rol të rëndësishëm në organizim, mbështetje logjistike dhe promovimin e vlerave të shëndetit fizik dhe bashkëpunimit rajonal.

Perfshirja e studenteve në projekte të tilla është synim parësor i yni duke u ofruar mundësi për zhvillimin personal dhe përfshirjen aktive të tyre në aktivitete vendore dhe ndërkombëtare.



AKTIVITET HUMANITAR PËR DHURIMIN E GJAKUT

Këshilli Studentor, në bashkëpunim me ekipin e Transfuzionit të Gjakut, zhvilluan një aktivitet humanitar për dhurimin vullnetar të gjakut në ambientet e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit. Falënderim i veçantë për të gjithë studentët dhe stafin e fakultetit që me vullnet dhe humanitet iu përgjigjën kësaj nisme kaq të rëndësishme.



FEFS PËR BARAZI DHE PËRFSHIRJE NË SPORT!


Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit ishte ndër 15 institucionet sportive dhe edukative që, së bashku me Komitetin Olimpik të Kosovës, nënshkruan Deklaratën Ndërkombëtare "Brighton Plus Helsinki"
Një akt simbolik dhe praktik që afirmon përkushtimin tonë për barazi gjinore dhe fuqizimin e grave në sport.
Kjo deklaratë, e iniciuar nga IWG Women and Sport, përfaqëson një angazhim global për ndërtimin e një kulture sportive gjithëpërfshirëse, të drejtë dhe të qëndrueshme.



SEMINAR MBI TERAPINË PËRMES USHTRIMEVE FIZIKE NË KUADËR TË PROJEKTIT SHAPE ME PROFESORIN HARALD TSCHAN

Në kuadër të projektit SHAPE, është mbajtur seminari i radhës, me ligjëruesin e përgatitur nga profesori nga Vjena, Harald Tschan, dhe të konkretizuar e realizuar nga profesorët e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit (FEFS) për studentët. Tema e ligjëruesit ishte: "Exercise Therapy as an Accredited Sport Science Profession - Prevention / Rehabilitation / Exercise Therapy - Exercise is Medicine."

Seminari kishte për qëllim informimin e studentëve mbi zhvillimet më të reja në fushën e mjekësisë sportive, me theks të veçantë në parandalimin, rehabilitimin dhe terapinë përmes ushtrimeve fizike. Ky aktivitet kontribuoi në rritjen e njohurive profesionale të studentëve dhe në ndërgjegjësimin për rëndësinë e ushtrimeve fizike si formë efektive të parandalimit dhe trajtimit shëndetësor.



EOSE ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME DHE SEMINARI PËR ANËTARË 2025 NË MALTË

Në Maltë u zhvillua ngjarja vjetore e EOSE, e cila mbledhi për tri ditë përfaqësues nga vende të ndryshme evropiane për reflektim, debat dhe planifikim strategjik. Ngjarja bashkoi 49 pjesëmarrës nga 25 vende, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit pan-evropian në fushën e sportit dhe edukimit.

Eventi u organizua nga Sport Malta dhe përfshiu një sërë sesionesh të hapjes, prezantimesh tematike dhe diskutimesh mbi politikat sportive të BE-së. Në kuadër të programit u prezantuan aktivitetet e Sport Malta, zhvillimet e politikave evropiane për sportin, si dhe u mbajt Asambleja e Përgjithshme e EOSE 2025, ku u trajtuan çështje të anëtarësisë, raportet vjetore dhe zgjedhjet për Bordin Ekzekutiv.

Ngjarja u pasurua me mesazhe përhëndetëse dhe mbështetje për punën e EOSE nga drejtues të rëndësishëm evropianë dhe vendorë në fushën e sportit dhe përfshirjes sociale.

Në aktivitet mori pjesë edhe përfaqësues nga Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit, duke kontribuar në diskutimet profesionale dhe shkëmbimin ndërkombëtar të përvojave.




KONFERENCA E 5-të SHKENCORE NDËRKOMBËTARE E FEFS KU SPORTI TAKON SHKENCËN DHE E ARDHMJA MERR FORMË!

Me pjesëmarrjen e gjigantëve të sportit: Toni Kuka, Majlinda Kelmendi, Franco Foda dhe shumë personalitete të tjera ndërkombëtare e vendore të shkencës dhe sportit.









MIRËNJOHJE PËR VULLNETARËT QË KONTRIBUAN NË ORGANIZIMIN E KONFERENCË SË V-të FEFS

Menaxhmenti i Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, nën udhëheqjen e Dekanit Prof. Asoc. Dr. Florian Miftari, sot ndau mirënjohje për vullnetarët që kontribuan me përkushtim dhe profesionalizëm në organizimin e Konferencës së 5-të Shkencore në Edukim Fizik, Sport dhe Shëndet.

Falë punës së tyre të palodhshme, konferenca u zhvillua me sukses dhe la pas një standard të ri cilësie në organizimet akademike të fakultetit tonë. Vullnetarët tanë treguan frymë bashkëpunimi, përgjegjësi dhe përkushtim shembullor.

Një falënderim i veçantë për secilin prej tyre. Kontributi juaj është vlerë dhe inspirim për komunitetin tonë akademik.



TURNIRI XXVIII NDËRKOMBËTAR STUDENTOR NË DUBROVNIK!

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit ka nisur me sukses pjesëmarrjen në një nga turniret studentore më të vjetra dhe më të rëndësishme në rajon. Sot, ekipi ynë i meshkujve në basketboll zhvilloi me energji dhe profesionalizëm ndeshjen e parë kundër ekipit të Mostarit, duke arritur një fitore bindëse që na mbush me krenari.

Ceremonia madhështore e hapjes së turnirit u zhvillua menjëherë pas ndeshjeve të para, duke rikujtuar traditën e gjatë dhe rëndësinë që ky event ka për komunitetin studentor ndërkombëtar. Fakulteti ynë, si çdo vit, vazhdon të mbajë një vend të veçantë në këtë turnir, falë pjesëmarrjes aktive, disiplinës dhe rezultateve të vazhdueshme të studentëve tanë.

Vlen të theksohet se FEFS, në bashkëpunim me Federatën e Sporteve Universitare të Kosovës (FSUNK), po vazhdon angazhimin e përbashkët në përfaqësimin dinjitoz të studentëve tanë në arenën ndërkombëtare. Ky bashkëpunim i qëndrueshëm ndër vite ka kontribuar ndjeshëm në organizimin, përgatitjet dhe sukseset e ekipeve tona.

Urojmë shumë suksese për ekipet tona në ndeshjet e radhës dhe jemi krenarë për përkushtimin, shpirtin garues dhe profesionalizmin që po tregojnë studentët tanë në këtë edicion të turnirit.



U PËRMBYLL ME SUKSES XXVIII TURNIRI NDËRKOMBËTAR STUDENTOR NË DUBROVNIK!

Në ditën e fundit, ekipet tona të volejbollit dhe basketbollit zhvilluan ndeshjet gjysëmfinale të tyre. Me lojë të fortë, luftë deri në pikën e fundit dhe shpirt të vërtetë ekipi, të dy ekipet e FEFS-it siguruan vendin e tretë, duke sjellë një rezultat mjaft të mirë dhe plot krenari për fakultetin. Respekt maksimal për studentët tanë që e dhanë maksimumin gjatë gjithë turnirit. Vazhdojmë më fuqishëm se kurrë!





DION GALLAPENI NË INSTITUTIN E SHKENCAVE TË SPORTIT

Futbollisti i Kombëtares së Kosovës, Dion Gallapeni, ishte sportisti i radhës që vlerësimin e performancës fizike dhe funksionale ia besoi Institutit të Shkencave të Sportit, në kuadër të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit - Universiteti i Prishtinës.

Gjatë vizitës së tij, Dioni u prit nga menaxhmenti i fakultetit, të cilët e falënderuan për kontributin e jashtëzakonshëm dhe përkushtimin e tij në sukseset e Kombëtares së Kosovës, me theks të veçantë tek kualifikimi historik në play-off për Kampionatin Botëror 2026 në SHBA.

Instituti i Shkencave të Sportit vazhdon të mbështesë sportistët elitare përmes teknologjive bashkëkohore të vlerësimit, ekspertizës profesionale dhe qasjes shkencore, duke krijuar ura të forta bashkëpunimi mes akademisë dhe sportit të nivelit më të lartë.



ËSHTË MBAJTUR TAKIMI I RREGULLT I TRUPAVE KËSHILLËDHËNËS ME MENAXHMENTIN E FAKULTETIT TË EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT.

Takimi është zhvilluar në ambientet e Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), si institucioni më i lartë sportiv në vend, bazuar në rendin e ditës të parapërcaktuar.

Gjatë takimit u diskutuan tema me rëndësi strategjike për zhvillimin e Fakultetit, me theks të veçantë në mundësitë për përfshirjen e studentëve të FEFS-it në kuadër të Lojërave Mesdhetare 2030, përmes angazhimit në organizim, vullnetarizëm, praktika profesionale dhe aktivitete të tjera mbështetëse.

Po ashtu, u dhanë rekomandime lidhur me programet studimore aktuale, të cilat do të merren parasysh në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të tyre, në përputhje me zhvillimet bashkëkohore në sport dhe kërkesat e tregut të punës.

Vlen të theksohet se në këtë mbledhje është kooptuar anëtari i ri, Dr. Artan Qerkini, i cili konsiderohet një njohës i mirë i çështjeve juridike në fushën e sportit dhe pritet të japë kontribut të rëndësishëm në punën këshillëdhënëse të Trupit.

Takimi u vlerësua si konstruktiv dhe kontribuues në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit dhe institucioneve kryesore sportive në Republikën e Kosovës.



FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT PATI KËNAQËSINË TË MIRËPRESË ZNJ. NORA NIMANI MUSA, KOORDINATORE E PROGRAMEVE NGA UNITED STATES-KOSOVO EDUCATIONAL EXCHANGE BOARD (USKEB), NË KUADËR TË NJË VIZITE ZYRTARE NË FAKULTETIN TONË.

Gjatë takimit u diskutuan frytet e bashkëpunimit mes FEFS-së dhe Fulbright Program Scholar, profesoreshës Megan Chawansky nga Otterbein University, e cila po përmbyll me sukses angazhimin e saj tre-mujor në fakultetin tonë. Dekani i FEFS-së, Miftari, theksoi rëndësinë e këtij bashkëpunimi ndërkombëtar, duke vënë në pah ndikimin e tij të drejtpërdrejtë në avancimin akademik, shkëmbimin e përvojave profesionale dhe krijimin e mundësive të reja për bashkëpunime të ardhshme në forma dhe programe të ndryshme.

Në këtë rast, Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit shpreh falënderim të veçantë për profesoreshën Megan Chawansky për kontributin e saj të çmuar akademik, profesional dhe njerëzor gjatë qëndrimit në institucionin tonë, si dhe për angazhimin e vazhdueshëm në forcimin e lidhjeve ndërmjet universiteteve dhe komuniteteve akademike ndërkombëtare.

FEFS mbetet i përkushtuar ndaj bashkëpunimeve që sjellin vlera të qëndrueshme për studentët, stafin dhe zhvillimin institucional.



U MBAJT NJË TAKIM NDËRMJET MENAXHMENTIT TË FAKULTETIT TË EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT (FEFS) DHE PËRFAQËSUESEVE TË MEDIUMIT KOSOVAPRESS.

Nga KosovaPress në takim morën pjesë:

Suzana Rakovica, Drejtoreshë e Përgjithshme

Merita Gashi, Zëvendësdrejtoreshë

Ardiana Bytyqi, Koordinatore e Projekteve.

Gjatë takimit u diskutuan mundësitë e përfshirjes së studentëve të FEFS-it në KosovaPress për punë praktike, ku ata do të angazhohen në sektorin e sportit, me qëllim promovimin e aktiviteteve sportive, si dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta në të ardhmen.

Po ashtu, u trajtuan programet e mundshme bashkëpunuese në fushën e gazetarisë sportive, me synim krijimin e hapësirave të reja për zhvillim profesional dhe praktik të studentëve.

Ky takim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, duke ndërlidhur arsimin universitar me median dhe tregun e punës, në funksion të avancimit të cilësisë akademike dhe profesionale.



FALEMINDERIT NGA ZEMRA!

Në këtë fundviti, dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë më të sinqertë për stafin administrativ, stafin e mirëmbajtjes së higjienës dhe sigurimin e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit. Ju jeni energjia e heshtur, por thelbësore, që e mban fakultetin funksional çdo ditë.

Falë përkushtimit tuaj:

- zyrat funksionojnë me rregull dhe profesionalizëm,
- ambientet tona janë të pastra, të rregullta dhe mikpritëse,
- fakulteti është i sigurt për studentët, stafin dhe të gjithë vizitorët.

Puna juaj shpesh nuk është gjithmonë e dukshme, por vlera e saj ndihet çdo ditë. Ju jeni shtyllë e rëndësishme e jetës institucionale të FEFS-it dhe pa ju, sukcesi i përbashkët nuk do të ishte i mundur.

Ju falënderojmë për angazhimin, korrektësinë dhe përgjegjësinë tuaj të vazhdueshme.


Ju urojmë shëndet, mirëqenie dhe një vit të ri plot qetësi, respekt dhe suksese personale e profesionale.

Faleminderit për gjithçka që bëni, çdo ditë, në heshtje, me zemër.



Për më shumë informata, ju lutem kontaktoni :

 fefs@uni-pr.edu

 +383 38 243 747



Copyright (C) 2025 Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit
Universiteti i Prishtinës